

## GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 49, deri më 08.12.2024)


### Të dhëna javore

Gjatë javës së dyzetë e nëntë të vitit 2024 (nga 02-08.12.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 88 raste ( $I=3,5/100.000$  banorë) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 35,4 më shumë se javën e kaluar (65). Krahasuar me javën e dyzetë e nëntë të vitit të kaluar (87), numri është rritur për 1,1%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (80) është regjistruar një rënie prej 3,1%.

Gjatë javës së 49 të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 14 materiale për analiza laboratorike për gripin, nga të cilat 10 nga mbikëqyrja SARI dhe 4 nga mbikëqyrja rutinore, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19, 1 material ka rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit– Influenza A(H1)pdm, si dhe është regjistruar një rast pozitiv me RSV.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit ( $I=26,1/100.000$ ) është nën pragun sezonal, pra ende nuk është arritur pragu i aktivitetit sezonal për hyrje në sezonin e gripit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025



Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në Gostivar – 28, Strumicë dhe Dibër – nga 15, Shkup – 8, Kumanovë dhe Tetovë – nga 7, Kavadar dhe Prilep – nga 3 dhe Manastir dhe Shtip – nga 1.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 53 persona, tek grupmosha 5-14 – 16, tek grupmosha mbi 65 vjet – 14 dhe tek fëmijët nga 0-4 -5 raste. Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha 5-14 vjet (7,5/100.000).

### **Të dhëna kumulative**

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 542 raste (I=29,5/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=551), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rënie prej 1,6%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=574) është regjistruar një rënie prej 5,6%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 16 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=147) është regjistruar në Kumanovë, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (168,9/100.000) është regjistruar në territorin e Gostivarit.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) - 331 raste (61,1%), ndërsa incidencë më e lartë (50,7/100.000) tek fëmijët e moshës 5-14 vjet (n=109).

### **MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE**

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e 49, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 165 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Deri më tani janë regjistruar 2 raste me SARS-CoV-2 dhe një me RSV, dhe një rast me grip - Influenza A(H1)pdm.

### **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.062 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.824 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 71.886 persona me vaksina falas dhe komerciale.

### **RAJONI EVROPIAN - ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary)**

\*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e 48 të sezonit të ri 2024/2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit është në nivel messezonal, që është karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 12 nga 29 vende të rajonit evropian të OBSH-së.

Numri i rasteve me SARS-COV-2 vazhdon të bjerë, por ka dallime mes vendeve. Grupmoshat më të mëdha vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të rasteve. Aktiviteti i gripit dhe RSV javëve të fundit ka shënuar një rritje të lehtë. Aktiviteti i virusit të gripit në të gjithë rajonin në dy javët e fundit ka filluar të rritet.

Në nivel rajonal, pranimet në spital dhe në repartet e kujdesit intensiv si pasojë e gripit dhe RSV janë në nivele stabile. Pranimet si pasojë e SARS-COV-2 po bien.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse  
Instituti i Shëndetit Publik**